



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 11/09/2020 Ref.: 1568/20

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 82-të, të mbajtur më 02.09.2020, mori:

V E N D I M

- I. Ri/akreditoohen programet e studimit të Fakultetit të Mjekësisë së Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” për periudhën tre vjeçare, 1 Tetor 2020 – 30 Shtator 2023:
 - Infermieri (BSc), 180 ECTS, maksimumi 100 student për vit akademik
 - Fizioterapi (BSc), 180 ECTS, maksimum 50 student për vit akademik
- II. Obligohet Fakulteti i Mjekësisë i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që deri me datë 31 tetor 2020 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti i Mjekësisë, ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim të programeve të studimit të cekura në dispozitiv I të këtij vendimi. AKA ka organizuar vizita të ndara në distancë të akreditimit me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin e Mjekësisë së Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit: Infermieri BSc dhe Fizioterapi BSc.


Vizita e parë në distancë është realizuar me datë 25.06.2020 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Helvi Kyngas dhe Delia Gologan. Vizita e dytë në distancë është realizuar me datë 26.06.2020 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Danica Zeleznik, Markus Paulmichl dhe Ketevani Kankava.

Sipas ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, programet e studimit të përmendura në dispozitivin I të këtij vendimi përmbushin plotësisht standardet e akreditimit të përcaktuara në Manualin e Akreditimit dhe rrjedhimisht kanë rekomanduar ri/akreditimin e tyre. Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 02.09.2020 ka shqyrtuar aplikacionin e Fakultetit të Mjekësisë së Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti i Mjekësisë;
- MASH;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë